



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi

VENDIM

Nr. 207, Datë 27.09.2018

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË  
“ALBGAZ” SH.A. MBI MIRATIMIN PARAPRAK TË ZYRTARIT TË  
PËRPUTHSHMËRISË SË OST TË GAZIT NATYROR**

Në mbështetje të nenit 16, të Ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 47 të Ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”; nenit 19, pika 1, të “Rregullave të Organizimit, Funksionimit dhe Procedurave të ERE”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE Nr. 96, datë 17.06.2016; Vendimit nr.179, datë 08.11.2017, të Bordit të ERE “Mbi çertifikimin e shoqërisë “Operatori i Kombinuar i Gazit Natyror”, ALBGAZ sh.a. “; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 27.09.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoritë Teknike, mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “ALBGAZ” sh.a., mbi miratimin paraprak të Zyrtarit të Përputhshmërisë së OST të Gazit Natyror,

**Konstatoi se:**

- Bordi i ERE me Vendimin nr. 179, datë 08.11.2017, ka certifikuar “Operatorin e kombinuar të gazit natyror”, ALBGAZ sh.a..
- Shoqëria “ALBGAZ” sh.a. me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 565 Prot, datë 03.09.2018, ka paraqitur kërkesën për miratimin paraprak të kandidaturës së Zyrtarit të Përputhshmërisë.
- Shoqëria “ALBGAZ” sh.a., duhet të paraqesë për miratim në ERE “Kërkesat minimale për Zyrtarin e Përputhshmërisë, kriteret profesionale, si dhe kriteret e tjera përzgjedhëse”, detyrim i cili buron nga “Programi i Përputhshmërisë”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 77, datë 26.05.2017.
- ERE ka miratuar kontratën e Zyrtarit të Përputhshmërisë, sipas nenit 47 të Ligjit nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror” me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 78, datë 26.05.2017

- Konform nenit 47, pika 1 të Ligjit Nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, OST-ja krijon një program të përputhshmërisë, në të cilin përcaktohen masat e nevojshme për garantimin e sjelljes jodiskriminuese, i cili miratohet nga ERE, si dhe metodën për monitorimin e përputhshmërisë me këtë program. Programi i përputhshmërisë përcakton detyrimet e veçanta për të punësuarit e OST-së, me qëllim plotësimin e këtyre objektivave. Përputhshmëria me programin monitorohet në mënyrë të pavarur nga një zyrtar i përputhshmërisë.
- Kontrata e Zyrtarit të Përputhshmërisë në nenin 2.1 të saj përcakton se: “Zyrtari i Përputhshmërisë duhet të përmbushë kërkesat minimale për kriteret profesionale dhe kriteret e tjera përzgjedhëse të vendosura nga OST [organi përkatës] dhe miratohen nga ERE dhe që janë zbatuar për përzgjedhjen e Zyrtarit të Përputhshmërisë. Zyrtari i Përputhshmërisë duhet të plotësojë kriteret profesionale dhe kriteret e tjera përzgjedhëse gjatë periudhës së vlefshmërisë së Kontratës. Kriteret profesionale dhe kriteret e tjera përzgjedhëse, të vendosura nga OST [organi përkatës] dhe të miratuara nga ERE, duhet të bashkëngjiten në [Shtojcën II] të kësaj Kontrate.

Për gjithë sa më sipër Bordi i ERE,

#### **Vendosi:**

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “ALBGAZ” sh.a., për miratimin paraprak të Zyrtarit të Përputhshmërisë së OST së Gazit Natyror.
2. Shoqëria “ALBGAZ” sh.a., të paraqesë në ERE për miratim “Kërkesat minimale për Zyrtarin e Përputhshmërisë, kriteret profesionale, si dhe kriteret e tjera përzgjedhëse”.
3. Shoqëria “ALBGAZ” sh.a., të informojë ERE-n dhe Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë në vijimësi lidhur me kërkesat e pikës 73 (raportimi për zbatimin e programit) të “Programit të përputhshmërisë të Operatorit të Sistemit të Transmetimit për Gazin Natyror” të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 77, datë 26.05.2017.
4. Drejtoria e Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit, të njoftojë Albغاز sha, për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Petrit AHMETI**